



Kolegji AAB

CILËSI. LEADERSHIP. SUKSESI!

**Rregullore për
Përdorimin e Automjeteve
Zyrtare**



RREGULLORE nr.2379/14
PËR
PËRDORIMIN E AUTOMJETEVE ZYRTARE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave për përdorimin e rregullt, efikas dhe ekonomik të automjeteve të Universitetit AAB.

Neni 2

Automjetet zyrtare janë të gjitha automjetet që janë në pronësi, apo në përdorim të Universitetit si veturat, autobusët etj.

Udhëtime zyrtare, nënkuptohen ato lëvizje të cilat kanë destinacion apo qëllim të caktuar, i cili shërben për kryerjen e detyrave zyrtare.

II. PËRDORIMI – SHFRYTËZIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE

Neni 3

Automjetet zyrtare nisjen e kanë nga Universiteti dhe në çdo rast plotësohet evidenca e transportit-fletudhëtimi që duhet të përmbajë: numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, kohën e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimet e udhëtimit, emrat e personave që udhëtojnë dhe numrin e kilometrave në momentin e kthimit, si dhe nënshkrimin e përdoruesit.

Formën e evidencës së transportit-fletudhëtimin e përcakton Menaxheri i shërbimit teknik.

Neni 4.

Të drejtën për ngasjen e automjeteve zyrtare e kanë të gjithë punonjësit që kanë patentë shofer të vlefshëm, që sigurojnë lejen e përdorimit nga Menaxheri i shërbimit teknik dhe autorizimin për përdorim nga Sekretari i Universitetit.

III. PROCEDURA E MARRJES SË AUTOMJETEVE NË SHFRYTËZIM

Neni 5.

I punësuari i cili ka nevojë të përdorë personalisht apo me vozitës automjetin për udhëtim zyrtar, së pari duhet të plotësojë formularin-kërkesën për shërbime të vozitjes.

Formën e formularit e përcakton Menaxheri i shërbimit teknik.

Për shërbimet e përditshme dhe lokale mjafton leja verbale e Menaxherit të shërbimit teknik.



IV. RREGULLA THEMELORE

Neni 6.

1. Shfrytëzimi i automjetit në distancë më të vogël se 1 km është i ndaluar.
2. Vozitësi është i obliguar të ruajë automjetin zyrtar.
3. Të gjitha informatat zyrtare që vozitësi i mëson / dëgjon nga personat zyrtarë konsiderohen sekret i punës dhe përhapja e këtyre të dhënave, publikisht konsiderohet shkelje e detyrave të punës.
4. Është e ndaluar për vozitësit që personave jo kompetentë t'u bëhet i ditur relacioni i rrugës i personit zyrtar.
5. Drejtuesit të automjetit zyrtar nuk i lejohet transporti i personave që nuk janë nëpunës të Universitetit përveç kur autorizohet për një gjë të tillë.
6. Veturat e Universitetit në pjesën anësore, duhet ta kenë mbishkrimin "AAB".

V. PËRGJEGJËSIA PËR MIRËMBAJTJEN DHE DREJTIMIN E AUTOMJETEVE ZYRTARE

Neni 7.

Mirëmbajtja dhe servisimi

1. Drejtuesi i automjetit zyrtar është përgjegjës për mirëmbajtjen e tij. Për këtë qëllim çdo drejtues bën kontrollimin ditor apo sipas nevojës të automjetit.
2. Drejtuesi është përgjegjës që automjeti zyrtar të jetë parkuar siç duhet dhe të mos rrezikohet nga vjedhësit, aksidentet apo gjokat e mundshme.
3. Servisimi dhe ndreqja e automjeteve bëhet vetëm në operatorin e zgjedhur nga shërbimi i prokurimit.
4. Në rast aksidentesh apo dëmtimesh të tjera, ku drejtuesi nuk është fajtor, procedurën e servisimit dhe shpërbimit të dëmit e udhëheqë shërbimi i prokurimit.
5. Të gjitha faturat e servisimit, larjes dhe shpenzimeve të tjera të automjeteve i dorëzohen shërbimit të prokurimit përmes Menaxherit të shërbimit teknik.
6. Të gjitha automjetet zyrtare, me përjashtim të automjetit zyrtar të Kryetarit të Bordit, Rektorit dhe atyre që kanë leje për përdorim 24 orë, pas përfundimit të orarit të punës duhet të parkohen dhe të qëndrojnë në parkingjet e Universitetit, përjashtimisht pas orarit të punës mund të përdoret me një arsyetim përkatës dhe me marrjen e lejes nga Menaxheri i shërbimit teknik.
7. Përdoruesi i automjetit zyrtar duhet t'i zbatojë rregullat e përgjithshme të trafikut dhe është përgjegjës për shfrytëzimin e kujdesshëm të automjetit, si dhe përgjigjet për dëmin eventual të shkaktuar me fajin e tij dhe për të gjitha gjokat që shqiptohen si rezultat i shkeljes së rregullave të trafikut.

VI. DISPOZITAT PËRFINDIMTARE

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Rektori i Universitetit.

Dr. Lulzim Tafa, Rektori

Data: 04.01.2014

